



29-09-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 2433-2021

Në pajtim me autorizimet e dhëna në nenin 83 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullën Nr.16/2013, për Themelimin e Qendrave të Votimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.09.2021, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Rekomandimit për Ndryshimin e Lokacionit të Qendrës së Votimit 1912e në Komunën e Prishtinës, për Zgjedhjet Lokale 2021

- I. Miratohet rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të Qendrës së Votimit 1912E, në Komunën e Prishtinës, për zgjedhjet lokale 2021.
- II.Rekomandimi si në pikën I. është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III.Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.09.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radonjic  
  
Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Priština  
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Data/Datum 29.09.2021

Për/Za Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Permes/Preko Këshillit për Operacione Zgjedhore  
Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së

Nga/Od Nexhmedin Hyseni, Drejtor i Departamentit të Koordinimit në Terren  
Sekretariati i KQZ-së

Kopje/Kopija Arkivës së KQZ-së

**Rekomandim**

Lënda/Predmet **Për ndryshimin e adresës/lokacionit për Qendren e Votimit 1912/e në komunën e Prishtinës për Zgjedhjet Lokale 2021**

Të nderuar,

Bazuar në paragrafin 4 dhe 5 të nenit 83 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, dhe Rregullën Zgjedhore 16/2013, Sekretariati (DKT), brenda afateve të parapara me Planin Operacional të KQZ-së për Zgjedhjet Lokale të 17 tetorit 2021, ka bërë publikimin e lokacioneve të Qendrave të Votimit për Zgjedhjet Lokale 2021, ku një (1) prej tyre, për shkak të rëndësisë shtetërore që përdor Ministria e Shëndetësisë, KQZ është e duhet të ndryshon lokacionin e kësaj QV në:

- **PRISHTINË:**

Qendra e Votimit 1912/e në Prishtinë, adresa/lokacioni “Salla e Sporteve 1 tetori” e cila adresë ka qenë QV e zakonshme në Prishtinë, tashmë objekti në fjalë është duke u përdorur nga Ministria e Shëndetësisë si Qendër Vaksinimi, dhe për shkak të rrethanave objektive, KQZ e ka patur të pamundur që të rikthehet ky objekt për ditën e zgjedhjeve me datë 17 tetor 2021, pasi i njëjti objekt ka qenë edhe Depo e KKZ-së. Ndërsa si QV alternative për këtë, kemi identifikuar objektin e Fakultetit të Edukimit, dhe për Depo të KKZ-së, Sallën e Sporteve të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. Ku pas kërkesës zyrtare (Nr.2268-2021) datë 13.09.2021 që i ka bërë SKQZ, Rektoratit të UP-së për shfrytëzimin e hapësirave të objekteve në fjalë për këto zgjedhje. Rektorati i UP-së me datë 21.09.2021 në përgjigjen zyrtare (Nr.1/560) të pranuar në KQZ me datë 22.09.2021 (Nr.2268/A-2021).


Ndaj, lidhur me këtë, DKT rekomandon të miratohet ndryshimi i adresës/lokacionit të QV-së 1912/e nga “Salla e Sporteve 1 tetori” në adresën/lokacionin **Fakulteti i Edukimit** – Prishtinë.

Me respekt!



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhevdet Bushi, Ndërtesa e Rektoratit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@un-pr.edu • www.un-pr.edu



Sekretar i Përgjithshëm

Esat KELMENDI

Nr. Prot.:

11560

Date

21, 9, 2021

**Për:** Z. Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së  
**Nga:** Esat Kelmendi, Sekretar i Përgjithshëm, Universiteti i Prishtinës  
**Lënda:** Përgjigje në kërkesën tuaj nr. 2268-2021, datë 13.09.2021

I nderuar Kryeshef z. Ahmetaj,

Universiteti i Prishtinës është mirënjohës për gjithë përkrahjen logjistike që KQZ i ka dhënë UP-së ndër vite me rastin e organizimit të zgjedhjeve studentore dhe zgjedhjeve të personelit akademik. Edhe përkundër faktit që si rrjedhojë e masave preventive Anti Covid-19, të gjitha provimet e afatit të shtatorit dhe provimet pranuese për pranimin e studentëve të ri janë shtyrë për në muajin tetor, në konsultim me dekanët e dy njësive akademike, jemi pajtuar që të gjejmë zgjidhje alternative në mënyrë që t'i dalim në ndihmë KQZ-së dhe sipas kërkesës tuaj t'ua japim në shfrytëzim Amfiteatrin dhe katër (4) klasë në katin përdehës të Fakultetit të Edukimit, të cilat do të shërbejnë si qendër e votimit, si dhe Sallën e Sporteve në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, e cila do të shërbejë për vendosjen e materialit administrativ jo të ndjeshëm dhe materialit të ndjeshëm "Fletëvotimet".

Do të jemi mirënjohës nëse pas procesit të votimit i dezinfektoni hapësirat e F. Edukimit në të cilat është zhvilluar aktiviteti zgjedhor, për shkak se në ato hapësira menjëherë parashihet fillimi i procesit mësimor.

Ju urojmë suksese dhe punë të mbarë!

Me respekt,

Esat Kelmendi

Sekretar i Përgjithshëm / UP-së

